




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br Prot <u>01-4555/13</u>
Dep.	Prot No
Nr ifaq	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>31.12.2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	17/12/2013
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK - DPKPP
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Gazmend RASHITI Drejtor i Prokurimit në QKUK
<b>CC:</b>	z. Nijazi GASHI Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion për Tenderin: "Furnizimi me pjesë rezervë për pajisje mjekësore"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: "Furnizimi me pjesë rezervë për pajisje mjekësore" me numër të prokurimit: 701-13 -170-111", Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Në lidhje me monitorimin e procesit të prokurimit, për tenderin: "Furnizimi me pjesë rezervë për pajisje mjekësore" me numër të prokurimit: 701-13 -170-111", i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka hasur në ndonjë shkelje që mund të shpie drejt shpërblimit me kontratë në bazë jo meritore.

## A r s y e t i m

Qendra Klinike Universitare e Kosovë - QKUK më datë 30/10/2013 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Furnizimi me pjesë rezervë për pajisje mjekësore” me numër të prokurimit: 701-13 -170-111”

Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim.

Më datë 21/11/2013 Agjencia Kundër Korrupsion përmes një shkrese ka njoftuar Autoritetin Kontraktues – Qendra Klinike Universitare e Kosovë - QKUK për pjesëmarrje (monitorim) në vlerësimin e tenderit. Qendra Klinike Universitare e Kosovë - QKUK si autoritet përgjegjës ka njoftuar Agjencinë që vlerësimi do të filloj më datë 22/11/2012. Pjesëmarrës në këtë vlerësim ishte edhe Agjencia Kundër Korrupsion, në cilësinë e monitoruesit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave për tenderin: “Furnizimi me pjesë rezervë për pajisje mjekësore”, me nr. Prokurimi: 701-13-170-111 në raportin e vlerësimit, deklaroi unanimisht, se: Me këto kritere të vendosura si dhe me këtë specifikim jo të detajuar, nuk mund të bëhet vlerësim i mirëfilltë i ofertave dhe si rrjedhojë mund të ketë edhe lëshime të mëdha gjatë vlerësimit. Prandaj ky komision propozon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit në mënyrë që të shmangen gabimet që mund të bëhen gjatë propozimeve për dhënie të kontratës.

Me qenë se nuk janë kërkuar:

1. Deklarata e konformitetit , e cila e tregon prodhuesin si dhe kompatibilitetin e produkteve
2. Certifikata ISO e standardeve të cilësisë
3. CE - certifikata e kualitetit

Në mungesë të këtyre certifikatave, në katalogët e shumicës së ofertueseve nuk i dihen as prodhuesit, as cilësia dhe as kompatibiliteti.

Nga kjo që u tha më lartë, komisioni në raportin e vlerësimit ka rekomanduar anulimin e kësaj procedure të prokurimit.

Me respekt!